

## UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E RECETËS MJEKËSORE

---

Në mbështetje të pikës 69, të nenit 3, të ligjit nr 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, receta mjekësore, sipas përcaktimit të saj në nenin 52 të ligjit të sipër cituar të barnave, klasifikohet në receta për:

- Barna të regjistruara në regjistrin e barnave
- Barna biologjike
- Vaksinat

Receta mjekësore për barna të regjistruara në regjistrin e barnave përbëhet nga 6 ( gjashtë) pjesë:

- i. **Të dhënat e mjekut:** Në këtë pjesë shënohet emër mbiemër i mjekut, institucionit shëndetësor, numri i licencës së mjekut lëshuar nga Urdhi i Mjekut të Republikës së Shqipërisë.
- ii. **Të dhënat e pacientit:** Në këtë pjesë të recetës shënohet emri dhe mbiemri i të sëmurit, mosha, pesha trupore, gjinia, numri personale sipas kartës së identitetit dhe adresa e tij.
- iii. **Diagnoza e pacientit.** Në këtë pjesë përshkruhet, tipi i diagnozës (akut/kronik), diagnoza e pacientit dhe kodi përkatës i diagnozës në sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të sëmundjeve ICD 9
- iv. **Përshkrimi i medikamentit:** Në këtë pjesë përshkruhen, deri në 4(katër) barna të lëshuara për diagnozën e përshkruar. Nëse terapia farmaceutike e lëshuar nga mjeku përbëhet nga më shumë se 4(katër) barna të përshkruara në faqen e parë të recetës. Bari përshkruhet si më poshtë:
  1. Emërtimi xhenerik (sipas regjistrin të barnave)
  2. Formë doza (e rekomanduar)
  3. Terapia e rekomanduar(mënyra e marrjes të medikamentit)
  4. Kohëzgjatja e terapisë
  5. Shënime (rekomandime nga specialisti)
- v. **Nënshkrimi i recetës nga mjeku:** Në fund të recetës, mjeku shënon datën e lëshimit të recetës, nënshkruan dhe vulos recetën.

vi. **Nënshkrimi i recetës nga farmacisti:** Në fund të recetës, farmacisti shënon datën e ekzekutimit të recetës, nënshkruan dhe vulos recetën.

**KUJDES!** Receta lëshohet në dy kopje. Një kopje e mbahet nga farmacisti dhe një kopje mbahet nga pacienti. Çdo recetë do të ketë numrin e vet serial si pjesë të formatit të shtypshkrimit të prodhuar nga shtypshkronja e letrave me vlerë.